# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-454913**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 7 të arrestuar dhe mbi 6800 gjoba në 72 orë, Policia Rrugore e Tiranës shton kontrollet - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/7-te-arrestuar-dhe-mbi-6800-gjoba-ne-72-ore-policia-rrugore-e-tiranes-shton-kontrollet/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 11:37:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 11:35:49 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `607d9df187e577b7d455a154088e47518fa6d44aef5e9a0052492024e7d982e3` |
| TEKSTI | `de8095f0e219992163ee26ab40b6b9342d81eb44436ebe2860915e02f7787e2f` |
| PAMJA | `e88186eb19fd6fde7ad740da50106a32a7f8eaf592b2cb76e70a7638f8f9df56` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ff5ed49facea55ba58aac3b08b5b754aa27e3cb38f85f14722d5e80b2da808c2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ff5ed49facea55ba58aac3b08b5b754aa27e3cb38f85f14722d5e80b2da808c2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# 7 të arrestuar dhe mbi 6800 gjoba në 72 orë, Policia Rrugore e Tiranës shton kontrollet

18 Shtator 2026 | 13:35

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Policia Rrugore e Tiranës ka vijuar kontrollet 24 orë në 7 ditë në akset rrugore me frekuentim të lartë, me qëllim parandalimin e aksidenteve dhe ndëshkimin e drejtuesve që shkelin rregullat e qarkullimit.

Gjatë 72 orëve të fundit, kontrollet kanë çuar në arrestimin e 7 drejtuesve të mjeteve për vepra penale në fushën e qarkullimit rrugor. Gjithashtu, janë bllokuar 22 mjete dhe janë tërhequr 20 leje drejtimi.

Një tjetër drejtues mjeti është proceduar pasi u konstatua në rrugën “Urani Pano” duke drejtuar automjetin nën efektin e alkoolit. Sipas Policisë, testi rezultoi në masën 0.17 mg/l, ndërsa drejtuesi dyshohet se i ka ofruar punonjësit të Policisë 2000 lekë, me qëllim shmangien e masës administrative.

Në total, gjatë kontrolleve janë vendosur 6819 masa administrative për shkelje të ndryshme të rregullave të qarkullimit rrugor.

Shkeljet e konstatuara përfshijnë:

5062 masa për qëndrim të gabuar;

641 masa për mospërdorim të kaskës mbrojtëse/jelekut fosforeshent;

193 masa për mosvendosje të rripit të sigurimit;

166 masa për mosdhënie përparësie këmbësorëve;

164 masa për përdorim të celularit gjatë drejtimit të mjetit;

74 masa për parakalime të gabuara;

59 masa për tejkalim të shpejtësisë;

10 masa për drejtim të mjetit nën efektin e alkoolit;

289 masa për mosrespektim të sinjalistikës rrugore.

Policia Rrugore e Tiranës u bën apel drejtuesve të mjeteve për kujdes të shtuar gjatë fundjavës, respektimin e kufijve të shpejtësisë dhe sinjalistikës, përdorimin e rripit të sigurimit dhe kaskës mbrojtëse, si dhe shmangien e drejtimit të automjetit nën efektin e

LAJMI I FUNDIT

13:31 Turqia miraton marrëveshje bashkëpunimi me Brazilin në industrinë e mbrojtjes

13:29 Aktori turk dhe ish-lojtari i Galatasaray-t midis 16 të arrestuarve në bastisjet e drogës në Stamboll

13:23 Po kujdesej për bimët narkotike në mes të pyllit, arrestohet 37 vjeçari në Mirditë

13:21 Shkodër, 25-vjeçari rrëzohet aksidentalisht në një lokal, transportohet me helikopter në Tiranë

13:08 Fico: Nuk dua që Sllovakia të përfshihet në luftë për shkak të Nenit 5 të NATO-s

13:04 Djali i Jakup Krasniqit: Nuk dorëzohemi, të bashkohemi të gjithë shqiptarët e partitë politike

TESTIM

alkoolit.

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

### Po kujdesej për bimët narkotike në mes të pyllit, arrestohet 37 vjeçari në Mirditë

Policia e Mirditës ka kryer disa kontrolle me dronë në zona të thella malore, me objektiv parandalimin dhe goditjen e kultivimit të bimëve narkotike. Si...

13:23 | 18/09/2026

AKTUALITET

### Shkodër, 25-vjeçari rrëzohet aksidentalisht në një lokal, transportohet me helikopter në Tiranë

Një 25-vjeçar është dëmtuar në kokë pas një rrëzimi aksidental në një lokal në qytetin e Shkodrës. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 12:00. Sipas informacionit...

13:21 | 18/09/2026

AKTUALITET

### Operacioni "The Wanted", arrestohen në Itali dy shqiptarë të kërkuar nga drejtësia shqiptare

Dy shtetas shqiptarë të shpallur në kërkim ndërkombëtar janë arrestuar në Itali, në kuadër të dy fazave të tjera të operacionit të koduar "The Wanted". Operacioni...

12:32 | 18/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.